

FESTIVALI 59-të i KËNGËS NË RTSH

Aty ku kanë lindur zërat më të mirë Shqiptarë...
Aty ku krijuesit kanë bërë historin...
Aty ku tingujt muzikorë tingëllojnë si askund tjetër...
Aty ku nis flututrimi drejt europës dhe festivalit të madh europian...
Festivali...ëndrra e çdo artisti...

Radio Televizioni Shqiptar fton të gjithë krijuesit dhe interpretuesit të marrin pjesë në konkurim për të qenë pjesmarrës në Festivalin e 59 të këngës. Përzgjedhja e këngëve pjesmarrëse do të kryhet nga komisioni i seleksionimit të këngëve në bazë të dëgjimit të tyre. Konkurentet duhet të dorëzojnë pranë stafit të festivalit në Radio Tirana ose dërgojnë në postën elektronike festival@rtsh.al këngën e plotë me të gjitha specifikimet teknike si më poshtë:

1. Versionin përfundimtar të këngës të kënduar në formatin wave 16 bit 44.1 khz.
2. Versionin përfundimtar të bazës orkestrale me backvocal në formatin wave 16 bit 44.1 khz.
3. Versionin përfundimtar të bazës orkestrale pa backvocal në formatin wave 16 bit 44.1 khz.
4. Partiturën Vokale (me nota) të këngës e shoqëruar me tekstin përkatës në çdo masë.
5. Partiturën e plotë të këngës në nota (transkriptimin) e cila do të ekzekutohet live, për të gjithë formacionin orkestral të Festivalit (orkestër simfonike + band).
5. Versioni MIDI FILE i këngës.
6. Tekstin e plotë.
7. Foto të këngëtarit nëse është pjesmarrës për herë të parë në Festival
8. Biografi e shkurtër artistike e këngëtarit (aktiviteti, pjesmarrjet, çmimet etj).

- Të gjitha materialet e kërkuara më sipër duhet të jenë përfundimtare dhe të dorëzohen në datat 1 dhe 2 Tetor 2020 në zyrën e Festivalit në Radio Tirana ose postën elektronike festival@rtsh.al

(Mos plotësimi i njërës prej elementeve të kërkuar e s'kualifikon këngën nga konkursi i përzgjedhjes).

Email: festival@rtsh.al

Facebook: Festivali i kenges ne RTSH

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe ju urojmë suksese